

DEKRET
Nr.378, datë 27.11.1992

PËR FALJEN E STUDIOVE TË PUNËS TË PIKTORËVE DHE SKULPTORËVE

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit 7491, datë 29.04.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozim të Këshillit të Ministrave.

DEKRETOJ,

Neni 1

U falen piktorëve e skulptorëve studiot e punës të cilat u janë dhënë atyre nga ana e pushtetit për ushtrimin e veprimtarisë së tyre krijuese.

Përfshihen nga falja ato studio pune të cilat ndodhen në ndërtesa për të cilat ka pretendime pronësie.

Neni 2

Ngarkohen Bashkitë dhe degët e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve që të përcaktojnë personat që kanë në përdorim studiot e punës dhe që ushtrojnë veprimtari krijuese në to.

Neni 3

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

Kundërfirmohet:

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Aleksandër Meksi
SALI BERISHA